

LIGJ
Nr. 41/2015

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VEÇANTË PËR NEGOCIMIN DHE
LIDHJEN E KONTRATËS KONCESIONARE/PPP, ME OBJEKT NDËRTIMIN,
OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE MENAXHIMIN E RRUGËS SË ARBRIT,
NDËRMJET SHTETIT SHQIPTAR DHE SHOQËRISË “CHINA STATE
CONSTRUCTION COMPANY”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton procedurën e veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës koncesionare /PPP ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërisë “China State Construction Company” për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e Rrugës së Arbrit, si përjashtim nga procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

Neni 2

Procedura e negociimit

Procedura e negociimit për lidhjen e kontratës ndiqet nga Komisioni i Negocimit të Kontratës, kryesuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, dhe me anëtarë, përfaqësues të Ministrisë së Financave, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes, Ministrisë së Drejtësisë dhe Avokaturës së Shtetit.

Komisioni i Negocimit të Kontratës asistohet nga një konsulent i huaj, i cili bën vlerësimet ligjore dhe financiare të propozimit të paraqitur dhe kontratës që do të lidhet. Përzgjedhja e konsulentit bëhet nga Avokatura e Shtetit, në përputhje me vendimin nr. 392, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për marrëdhëniet e Avokaturës së Shtetit me institucionet shtetërore dhe entet publike, rolin e avokatëve të shtetit në gjykim, si dhe normat e posaçme procedurale””.

Komisioni i Negocimit të Kontratës negocion me shoqërinë “China State Construction Company” propozimin e paraqitur pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe përpilon projektkontratën finale, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave.

Projektkontrata, e shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati prej 60 ditësh nga nisja e negociatave, i dërgohet për nënshkrim Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Financave dhe Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes.

Neni 3

Nënshkrimi i kontratës

Nënshkrimi i kontratës bëhet nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes pas dorëzimit të projektkontratës dhe relacionit përmbyllës të negociatave nga komisioni negociues.

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Ministri i Financave dhe Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes mund t'i kërkojnë komisionit negociues rishikimin e

projektkontratës.

Komisioni i Negocimit të Kontratës duhet të rinegociojë dhe t'u paraqesë për nënshkrim ministrave projektkontratën, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave brenda afatit kohor prej 30 ditësh, duke filluar nga data e kthimit.

Neni 4

Miratimi i kontratës

Komisioni i Negocimit të Kontratës harton projektligjin për miratimin e kontratës dhe ia dërgon atë për miratim Këshillit të Ministrave, brenda afatit kohor prej 10 ditësh nga data e nënshkrimit nga tre ministrat.

Kontrata miratohet nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Data e hyrjes në fuqi të kontratës konsiderohet data e hyrjes në fuqi të ligjit pas miratimit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.4.2015

KRYETARI
Ilir Meta